



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 26, datë 16.01.2020

PËR

ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR.30, DATË 14.02.2019, “PËR RREGULLAT DHE PROCEDURËN E CAKTIMIT TË GJYQTARIT PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË NJË GJYKATË TJETËR, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN NË MËNYRË TË PËRHERSHME”, NË LIDHJE ME NEVOJAT E GJYKATËS SË APELIT KORÇË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 4, pika 3, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kushtet kur Gjykata e Apelit Korçë është jashtë funksioni për shkak të mungesës së numrit minimal të gjyqtarëve në detyrë, nevojat dhe kërkesat e saj për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta, deri në momentin e bërjes funksionale të kësaj gjykate, do të trajtohen si më poshtë:
 - a) Për çështjet që kanë të bëjnë me caktim, zëvendësim, revokim, bashkim ose shuarje të masave të sigurimit në lëndë penale, që do të regjistrohen deri më datë 31.07.2020, Këshilli miraton menjëherë, mbi bazën e shortit, një listë gjyqtarësh nga gjykatat e tjera të apelit, për çdo periudhë 10 ditore. Këshilli rishikon dhe përditëson listën e gjyqtarëve kur është e nevojshme.
 - b) Për çështjet sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, në rastin kur gjyqtari i caktuar sipas rregullit të kësaj shkronje nuk është në detyrë në periudhën 10 ditore përkatëse ose në rastin kur për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta, trupi gjykues formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur për të dy gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe

papajtueshmërie në çështje të veçanta. Në këtë rast, krahas gjyqtarit të caktuar për periudhën respektive, trupi gjykues formohet edhe nga dy gjyqtarët që gjenden të renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. Gjyqtari sipas situatës së parë të kësaj shkronje, kur është e mundur, përmbush detyrën në periudhën 10 ditore pasuese. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Korçë merr masa për njoftimin në kohë të gjyqtarit/gjyqtarëve zëvendësues.

- c) Kërkesat për caktim gjyqtari për çështjet që kanë të bëjnë me persona të paraburgosur në lëndë penale, si dhe për çështjet civile për të cilat ligji ka parashikuar afate të shkurtra gjykimi, do të trajtohen nga Këshilli sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, në mënyrë periodike, brenda afateve të arsyeshme.
- ç) Kërkesat për caktim gjyqtari të ndryshme nga ato sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, përfshirë edhe ato për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, do të trajtohen nga Këshilli sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, në mënyrë periodike, brenda afateve të arsyeshme, në varësi të numrit të kërkesave dhe duke respektuar parimin e barazisë përpara ligjit të shtetasve sa i përket të drejtës për të patur një gjykim të çështjes së tyre brenda një afati të arsyeshëm. Këshilli vendos për kohën e trajtimit të këtyre kërkesave, pas informacionit të marrë çdo muaj nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjykatave të apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR